

BPrAL Kolegji Heimerer

Bazuar në statutin si dhe në aktet tjera normative të brendshme të institucionit, BPrAL Kolegji Heimerer shpall:

KONKURS PUNE

Titulli: Hulumtues & Asistent/e për Hulmtime në Zyren per Hulmtime
Departamenti: Zyra për Hulmtime në kuadër te Prorektoratit për Hulmtime dhe Cilësi
Kontrata: 1 vjeqare me mundësi vazhdimi
Orari: Plotë - 40 orë në javë
I raporton: Udhëheqësit të Zyrës për Hulmtime

I. Roli

Asistimi i Zyrës për Hulmtime me ekspertizë specifike në hulmtime, ndihmë për studentët dhe koordinim i qështjeve tjera që ndërlidhen me arritjen e objektivave të Zyrës për Hulmtime.

II. Përgjegjësitë

1. Asistimi i Studentëve për Hulmtime

- a. Këshillim i studentëve në arritjen e objektivave të tyre hulumtuese, ndihmë me SPSS, analiza statistikore etj.
- b. Mbajtja e takimeve të rregullta javore (ose dyjavore) me studentë, me qëllim të avancimit të aftësive të tyre hulumtuese

Indikatori matës: Numri dhe përqindja e studentëve të asistuar

2. Asistimi i Zyrës për Hulmtime

- a. Përkrahja e dekanateve në bashkpunim me Udhëheqësin e Zyrës në arritjen e objektivave hulumtuese të dekanateve.
- b. Kryerja e detyrave tjera organizative dhe përkrahës, me qëllim të arritjes së synimeve të Zyrës për Hulmtime, në përputhje me kërkesat dhe sygjerimet e Udhëheqësit të Zyrës.
- c. Kryerja e detyrave tjera dokumentuese, që nevojiten sipas rregulloreve të kolegjit për Zyrën për Hulmtime.

Indikatori matës: Përqindja e objektivave hulumtuese që kanë arritur dekanatet.

3. Përkrahje në Organizimin e Simpoziumit dhe Konferencave Shkencore

- a. Përkrahja në organizimin e simpoziumeve dhe konferencave shkencore
- b. Përkrahja në pregaditjen e thirrjes për konferencë.
- c. Sygjerimet për dizajnim
- d. Promovimi i simpoziumeve/konferencave në rrjetet sociale
- e. Përkrahja në pregaditjen e dokumentacionit për akreditim të konferencave
- f. Përkrahje në hartimin e axhendës së konferencës

- g. Përkrahje në përzgjedhjen e studentëve vullnetarë për konferencë, në organizimin dhe trajnimin e tyre për kryer detyrat gjatë konferencave
- h. Përkrahje në rritjen e numrit të pjesëmarrësve pasiv dhe aktiv në konferenca
- i. Vlerësimi dhe përpilimi i raporteve të konferencave
- j. Ndihmë në gjetjen e donatorëve potencial për simpozium.

4. Hulumtimi

- k. Pjesëmarrja, përkrahja, dhe sipas nevojës udhëheqja e hulumtimeve të caktuara të cilat ndërmerren nga Kolegji Heimerer ose nën afilacionin e institucionit.
- l. Ndihmë në përkthimin e instrumenteve për hulumtim.
- m. Ndihmë në përfundimin e hulumtimeve të cilat kanë nevojë për përkrahje shtesë
- n. Gjetja e revistave shkencore potenciale ku mund të publikohen punimet e caktuara shkencore të studentëve ose të stafit mësimdhënës.

Indikatori matës: Numri i punimeve shkencore ku ka ndihmuar bashkpuntori/ja.

5. Asistimi

- a. Asistimi në lëndën “Bazat e biostatistikës” “Statistikë dhe Epidemiologji” në përputhje me kurrikulën dhe nevojat e Kolegjit Heimerer.

Indikatori matës: Numri i testeve të korigjuara, Përqindja e orëve të asistuar.

III. Indikatoret çelës të përformancës

- 1. Mbështetja e procesit të hartimit të planit të Zyrës për cilësi, duke i mbështetur njësitë e tjera në këtë proces;
 - a. Ndihmon në hartimit e planit të Zyrës për Hulumtime
 - b. Ndihmon në hartimin e raporteve periodike dhe vjetore

Indikatori i performancës: finalizimi i planit vjetor dhe i raporteve periodike dhe vjetore

IV. Njohuritë, Aftësitë dhe Zotësitë:

Arsimimi: Master ose Bachelor me kurrikulë ku ka pasur lëndë të mjaftueshme të statistikës dhe/ose metoda hulumtuese.

Pervoja: Përvojë të mjaftueshme në hulumtimet kuantitative, metodat hulumtuese dhe hulumtimet kualitative; përvoja në kontekstin ndërkombëtar është gjithashtu shumë e preferuar.

Njohuritë: analizim i të dhënave, dizajnimi adekuat të hulumtimeve në lëmitë ku ka kurrikulë intenzive të metodave hulumtuese, shkencave sociale dhe/ose shkencave shëndetësore, aftësi analitike, njohuri të avancuara të Gjuhës Angleze.

Aftësite Personale: Puna në ekip, e gatshme për të mësuar vazhdimisht, aftësi për zgjidhje të problemeve, dhe të ngajshme.

Aftësite Teknike: SPSS, Microsoft Office, Internet, Shkathtësi në përdorimin e revistave shkencore, dallimin e menjëhershëm të studimeve shkencore nga studimet jo-shkencore në internet.

Prirjet: Plotësisht transparent, integritet profesional, intuitë për respektimin e hierarkisë, dinamik, i drejtë, komunikativ, proaktive, lojal ndaj zyrës dhe institucionit.

V. Përshtatja e mjedisit

1. Pavarësi të rregulluar
2. Përkrahje adekuate
3. Qartësim të procedurave dhe rregullave
4. Mundësi promovimi

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë në info@kolegji-heimerer.eu dhe leonora.maxhuni@kolegji-heimerer.eu, CV-në në formatin Europass së bashku me dëshmitë për përvojën paraprake të punës dhe përgatitjen shkollore.

Dita e fundit për aplikim është 28.08.2018, në ora 17:00.

Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kolegji Heimerer ofron mjedis atraktiv për punë arsimore dhe profesionale dhe është një vend ideal për personat që kërkojnë të aplikojnë përvojën akademike edhe profesionale. Kolegji Heimerer aplikon të drejta të barabarta në punësim për të gjithë.